



Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ .2024

Formulari Nr. 3

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri "Identitek" Sh.a.
Adresa Rruga "Xhanfize Keko", Tiranë
Tel/Fax _____
E-mail procurement@identitek.al
Faqja e Internetit www.identitek.al

Autoriteti kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, nëpërmjet sistemit dinamik, me objekt: **"Blerje bileta udhëtimi ajror Tiranë - Bruksel - Tiranë"**.

Data e zhvillimit do të jetë **08.03.2024, ora 12:30**, në adresën www.app.gov.al.

Baza ligjore: Ligji Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, dhe Udhëzimi i APP-së nr. 3, datë 18.06.2021 *"Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike"*.

Sqarim i rëndësishëm: Autoriteti kontraktor nuk do të pranojë furnizim/shërbim nga operatorë ekonomikë që nuk mundësojnë lëshimin e faturës elektronike. Operatori fitues do të duhet të konfirmojë dhe të bëjë të mundur lëshimin e faturës elektronike në vijim të furnizimit/shërbimit të kërkuar.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi, me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

- **Bileta udhëtimi (vajtje - ardhje) Tiranë – Bruksel, copë 1 (një)**
me bagazhe të përfshira, klasi ekonomik, sipas itinerarit:

Tiranë - Bruksel (BRU), dt. 20.03.2024, ora 15:00 - ora 19:05; 1 Stop 45 min në Vienë;
Bruksel (CRL) - Tiranë, dt. 22.03.2024, ora 09:40 - ora 12:10; fluturim direkt;

Në shërbimin e blerjes së biletës, përfshihet edhe asistenca dhe ndihma e nevojshme që duhet të ofrojë operatori ekonomik fitues, kundrejt personave udhëtues, përfshirë check-in online nëse e nevojshme. Operatori fitues duhet të ofrojë çdo informacion të mundshëm, disponibilitet të menjëhershëm dhe asistencë të vazhdueshme, me qëllim mbarëvajtjen e udhëtimit në rast të problemeve që lidhen me rezervimin e biletës.

Operatori ekonomik, të cilit i dërgohet njoftimi i fituesit, duhet të njoftojë autoritetin kontraktor me mesazh elektronik në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), nëpërmjet skedarit “Kërkesat e Mia”, brenda 120 minutash nga momenti i dërgimit të Njoftimit të Fituesit, ku të lajmërojë mbi realizimin ose pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit, në njoftim duhet të jepen arsyet që e kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit.

Në kuadër të mbarëvajtjes së udhëtimit dhe marrjes së masave të nevojshme për këtë qëllim, operatori ekonomik do të duhet të ofrojë sigurinë nëpërmjet eksperiencës në treg dhe akreditimeve të nevojshme, mbi cilësinë e shërbimit. Për këtë arsye, në rast të marrjes përsipër të realizimit, operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë menjëherë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik:

1. Çertifikatë Akreditimi ose një Vërtetim nga IATA (Internacional Air Transport Association);
2. Rezervimin e Biletës sipas destinacionit dhe specifikimeve të kërkuara.

Bazuar në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik, Nr. 3, datë 18.06.2021 “*Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike*”, çdo ofertues do të verifikohet në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në rast se pas verifikimit, operatori ekonomik nuk rezulton me status aktiv dhe/ose nuk rezulton të ketë në fushën e veprimtarisë së tij objektin e prokurimit sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar, oferta do të refuzohet automatikisht.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të refuzojë automatikisht edhe oferta të paraqitura nga operatorë ekonomikë, të cilët në një procedurë të mëparshme prokurimi të zhvilluar nga autoriteti kontraktor gjatë këtij viti, nuk kanë njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë, mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Florian PASPALI